



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13472 Prot

Lezhë, më 29 / 07 /2022

VENDIM

Nr. 88, Datë 28 . 07 .2022

Për një ndryshim në VKB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024” dhe përdorim të fondit rezervë.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

I. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e KB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2022”, si më poshtë:

1/a- Pakësohet :

- Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.231 në shumën 9,700,000 lekë, për këto objekte : “Ndërtim ure në fshatin Troshan” në shumën 7,500,000 lekë, “Ndërtim ure në fshatin Sukaxhi” në shumën 500,000 lekë, “Ndërtim ure në fshatin Patalej” në shumën 600,000 lekë, “Ndërtimi i 2 urave këmbësore në fshatin Barbullojë” në shumën 500,000 lekë dhe “Ndërtimi i 3 stacioneve urbane në fshatrat Manati, Barbullojë dhe Kolsh” në shumën 600,000 lekë.

-Gr.00, Prog.05100, Kap.05, Art.602 në shumën 3,000,000 lekë, në zërin “Likujdim detyrime të prapambetura”.

1/b- Shtohet :

-Gr.00, Prog.04520, Kap.05, Art.602 për shumën 8,947,503 lekë, në zërin “Likujdim detyrime të prapambetura”.

-Gr.00, Prog.05200, Kap.05, Art.602 për shumën 1,822,680 lekë, në zërin “Likujdim detyrime të prapambetura”.

- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.602 për shumën 65,849 lekë, në zërin “Likujdim detyrime të prapambetura”.

- Gr.00, Prog.09230, Kap.05, Art.602 për shumën 1,220,988lekë, në zërin “Likujdim detyrime të pra-pambetura”.

- Gr.00, Prog.09240, Kap.05, Art.602 për shumën 642,980 lekë, në zërin “Likujdim detyrime të prapambetura”.

2. Përdorimi i fondit rezervë në shumën 2,788,707 lekë për likujdim të detyrimeve të prapambetura.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

2/a – Pakësohet: - Gr.00, Prog.04910, Kap.01, Art.609 për shumën 2,788,707 lekë “Fond rezervë”.

2/b – Shtohet : - Gr.00, Prog.04520, Kap.01, Art.602 për shumën 2,788,707 lekë, për zërin “Likujdim detyrimesh të prapambetura”.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Kesh
nr 13487 prot
df - 08.08.2022

Nr. 5497 Prot.

Lezhë, më 04.08.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 88, datë 28.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një ndryshim në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024” dhe përdorim të fondit rezervë”.

PREFEKTI

Gjergj PRENDI

